





DRITA RUDI / RAFET RUDI / DONIKA RUDI – BERISHAJ

EDUKATË MUZIKORE



PËR KLASËN E GJASHTË TË ARSIMIT TË MESËM TË ULËT

duk gjini
shtëpia botuese publishing house



DRITA RUDI / RAFET RUDI / DONIKA RUDI - BERISHAJ

EDUKATË MUZIKORE



Përmbajtja

1. HYRJE NË MUZIKË	5
Himni i Republikës së Kosovës	6
Këngë: Zilja po na fton	7
Fillet e muzikës në trevat shqiptare	8
Si të luajmë në blokflaut	9
Muzika klasike në Kosovë	10
Të rikujtojmë dhe të mësojmë masat 2/4, 3/4 dhe 4/4	12
Plotësoni	14
Detyrë	15
Valsi	16
Tema me variacione	17
Marshi	18
Paramasa	19
Këngë: Kori gazmor dhe shkalla G-dur	20
Krijë muzikë në bazë të tekstit	21
Dëgjim: Oda e gëzimit	22
Këngë: Libri i historisë	24
Këngë: Vjeshta	26
2. INSTRUMENTET MUZIKORE	29
Instrumentet muzikore	30
Harpa	32
Pianoja	33
Briri (korna)	34
Timpani	35
Muzika dhe artet e tjera	36
Poezi e katër stinëve të vitit	37
Sinkopa	38
Këngë: We wish you a Merry Christmas	39
Erdhi Viti i Ri	40
Shkalla e-mol	42
Këngë: Shqiponja dhe balona	43

3. MUZIKA VOKALE	45
Muzika vokale	46
Kyrie	50
Solo-kënga	51
Këngë: Vendi im	52
Forma e këngës dypjesëshe Këngë: Kur buzëqesh nëna	53
Format e këngës tripjesëshe Dëgjim: Erë e lehtë	54
Forma e këngës së përbërë tripjesëshe	55
Luajmë me instrumente.....	56
Këngë: Pranvera dhe masa 6/8	57
4. TRADITA	59
Instrumentet popullore ritmike	60
Instrumentet popullore melodike	61
Muzika popullore	62
5. MUZIKA INSTRUMENTALE	65
Formacionet kamertale.....	66
Orkestra harkore.....	68
Orkestra simfonike	69
Dëgjim: Ernest MacMillan "A Saint-Malo"	70
Dëgjim: Udhëtim muzikor në Jupiter Gustav Holst "Planetët".....	72
Triola	73
Kanoni	74
Zhanret muzikore	76
Fjalëkryqi.....	79
Këngë e cicërimë	80
Shkalla D-dur	81
Ushtrime melodike.....	82
Këngë: Vera	83
Fjalori.....	84
Ushtrime për dy blokflaute	85
Partiturë Korale: One bottle of pop.....	86
Partiturë korale: La violetta	88
	92
6. USHTRIME	89
Partitura të ndryshme	90

Parathënie

Të nderuar nxënës,

Libri që do të merrni në dorë, është i dedikuar për ju, me të vetmin qëllim që ju me lehtësi të depërtoni në botën e muzikës. Me ndihmën e librit, ju do t'i zgjeroni edhe më shumë njohuritë tuaja, të cilat, qysh në vitet e mëparshme keni filluar t'i zbuloni. Edhe më tutje, libri bazë i muzikës do të ngjallë te ju aftësinë për të krijuar, aftësinë tuaj për të lozur në instrumente, aftësinë tuaj për ta dëgjuar muzikën etj. Libri do t'ju ndihmojë që ta bëni dallimin në mes të muzikës së mirëfilltë dhe asaj jo të mirëfilltë. Me këtë do të zhvillohet edhe më shumë dashuria për muzikën. Gjithashtu, përmes këngëve të zgjedhura me kujdes, ju do të mësoni për vendin tuaj, për bukuritë dhe historinë e tij dhe do ta kuptoni vlerën që ka atdheu në jetën tuaj.

Autorët



An abstract painting with a vibrant, textured surface. The composition is dominated by a large, vertical red bar on the right side. The rest of the image is a complex interplay of colors, including deep blues, purples, oranges, and whites, with visible brushstrokes and layered textures. The overall effect is one of dynamic energy and visual richness.

1 Hyrje në muzikë



Himni i Republikës së Kosovës




Flamuri i Kosovës

Mendi Mengjiqi



NË FOKUS:



Mendi Mengjiqi (i lindur më 1958 në Podujevë) është autor i Himnit Shtetëror të Republikës së Kosovës.
Mengjiqi është autor i shumë veprave të rëndësishme muzikore.

Zilja po na fton

I.Deda
D.Angoni

C **G7**

Tring e tring e tring zi - lja po na th'rret. lam - tu - mir' pu - shi - me

C **C**

shko - lla po na pret pret. Me lu - le n'du - ar m'su - sen e rre -

F **G** **C**

thojm'. të gjith' të gë - zu - ar kla - sën po shi - kojn'. Tring e tring e

G7 **C**

tring zi - lja po na th'rret. lam - tu - mir' pu - shi - me shko - lla po na pret.

1

Tring e tring e tring,
zilja po na th'rret.
Lamtumir' pushime,
shkolla po na pret!


2

Me lule n'duar
mësuesen e rrethojmë
të gjithë të gëzuar
klasën po shikojmë


3

Tring e tring e tring,
zilja po na th'rret.
Lamtumir' pushime,
shkolla po na pret!


Ta rikujtojmë shkallën C-dur



C D E F G A H C



C D E F G A H C





Fillet e muzikës në trevat shqiptare

Okarina

Në bazë të monumenteve arkeologjike të ruajtura nga ilirët, në mesin e tyre edhe instrumente muzikore, dëshmohej se paraardhësit tanë kanë kultivuar me përkushtimartet dhe sidomos artin muzikor. Instrumenti që më së miri dëshmon këtë është “okarina” e gjetur në Ulpianën antike, instrument frymor ky që dardanët e kanë përdorur në festat dhe ahengjet e tyre.

Shkrimet, nga kjo kohë, mjerisht, nuk janë ruajtur.




Ndër shqiptarët e parë që e kultivoi muzikën e shkruar ishte Niketë Dardani, peshkop i Remisianës ilire, afër Nishit, i cili për nevoja të kishës shkruante në gjuhën latine këngë, himne etj. Himni “Te Deum” paraqet një rën prej veprave më të popullarizuara të muzikës kishtarë që nga shek. IV, kur ai jetoi, e deri më sot.

Më vonë shquhet durrsaku Jan Kukuzeli (shek. XIII), që në historinë e muzikës së përbotshme njihet si reformator i madh i shkrimit muzikor dhe Gjergj Danush Llapacaj (shek. XVI).

Gjatë sundimit turk nuk ekzistojnë shënime të ndonjë aktiviteti në këto treva. Por, disa muziktarë shqiptarë, siç dihet, zhvillnin aktivitete të rëndësishme në Raguza (Dubrovniku i sotëm) si Kolë Durrësaku, Filip Pjetër Drishti, Pjeter Spani, Kristofor Ulqini etj.

Shumë më vonë, pas një periudhe të vështirë të sundimit pesëqindvjeçar turk, në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX, në trevat shqiptare rilindësit tanë nisën aktivitetin edhe në fushën e muzikës artistike.




Jan Kukuzeli



Të dëgjojmë:

Niketë Dardani: **Te deum**

Si të luajmë në blokflaut



1. 2. 1. 2. 1. 2. 1. 2.

Dora e djathtë

Dora e majtë

○ E zbrazët ◯ Gjysmë e mbyllur ● E mbyllur

Si ta mbajmë blokflautin

Mbaj trupin drejt gjatë luajtjes në blokflaut dhe ulu në gjysmën e karriges si në ilustrimin më poshtë. Blokflautin e mban rreth 30 – 45 gradë larg gjoksit.



Me dorën e majtë mbulo vrimën e brendshme të blokflautit dhe tri vrimat e përparme, përderisa me dorën e djathtë mbulo katër vrimat e mbetura (gishti i vogël i dorës së majtë duhet të mbesë i lirë).



Muzika klasike në Kosovë

Për dallim nga muzika popullore që ka një traditë të gjatë në Kosovë, muzika klasike filloi të zhvillohet, në mënyrë më të organizuar, në vitet e dyzeta të shekullit XX, me hapjen e shkollës së parë muzikore në Prizren dhe me aktivitetin që zhvillon shoqëria "Agimi". Në këtë periudhë, krahas punës së vlefshme të kompozitorëve Lorenc Antoni e Rexho Mulliqi, që janë kompozitorët tanë të parë të zhanrit të muzikës klasike, fillojnë të shfaqen kompozitorët e tjerë të shkolluar, si: Esat Rizvanolli, Fahri Beqiri, Vinçenc Gjini, Mark Kaçinari etj.

Kori i Filharmonisë së Kosovës



Një lulëzim të madh dhe më të hovshëm kjo muzikë e përjetoi në vitet '70, me formimin e institucioneve të rëndësishme të muzikës, si Orkestra simfonike e Radio Televizionit të Prishtinës, korit profesional të RTP-së, formimit të Akademisë së Muzikës etj.

Me ardhjen në Kosovë të muziktarëve që sapo kishin mbaruar studimet në qendra të mëdha të ish-Jugosllavisë, si: Zeqirja Ballata, Bahri Çela (dirigjent), Rauf Dhomi, Bajar Berisha (dirigjent), Rafet Rudi, Bashkim Shehu etj., jeta muzikore në Kosovë shënon një përparim. Dallohen gjenerata e mesme e kompozitorëve si Mendi Mengjiqi, Valton Beqiri, violinistja Sihana Badivuku, pianistet Lejla Pula e Valbona Petrovci, flautistja Venera Mehmetagaj etj.

Në dy deceniet e fundit, muzika klasike te ne përjetoi një ngritje të madhe. Për aktivitet më të shënueshëm shquhet gjenerata më e re e kompozitorëve si: Kreshnik Aliçkaj, Dafina Zeqiri, Drinor Zymberi, Kushtrim Gashi, Donika Rudi, Lyra Kastrati etj. Me paraqitje të rëndësishme në skenën


ndërkombëtare shquhen: Merita Juniku mezzosoprano, kitaristi Petrit Çeku, tenori Ramë Lahaj, sopranot Elbenita Kajtazi, Marigona Qerkezi, Besa Llugiqi etj.



Ramë Lahaj, tenor



Petrit Çeku, kitarist



Sihana Badivuku, violiniste

Të dëgjojmë:




Petrit Çeku: Pjesë nga Suita e Bahut



Të rikujtojmë dhe të mësojmë masat 2/4, 3/4 dhe 4/4

Masat mund të jenë të ndryshme, por ato që do t'i mësojmë janë: 2/4 (dy lëvizje, një-dy) me ç'rast pjesa e parë e masës është e theksuar (teza) dhe e dyta më pak e theksuar (arza); 3/4 (tri lëvizje, një, dy, tre) pjesa e parë e masës është theksuar, kurse e dyta dhe e treta më pak të theksuara; 4/4 (katër lëvizje, një, dy, tre, katër), pjesa e parë e masës është e theksuar, përderisa e dyta, e treta dhe e katërta, më pak të theksuara.

Masa 2/4




Masa dykohore
Dy lëvizje dore
Një-dy, poshtë e lart.

2 _____ | _____ | _____ | _____ | _____ | _____ | _____
 4 Tring tring tring Zi-lja po na th'rrret, Lam - tu - mir'pu - shi-me, shko - lla po na pret.

Provoni me lëvizje të dorës: poshtë (pa-ra) dhe lart (dy-ta) duke ligjëruar tekstin lart.

Masa 3/4

Tashmë e dimë se numri 3 tregon sasinë e lëvizjeve në kohë, ndërsa numri 4 tregon vlerën e notës. Te masa tripjesore, rrokja e parë është e fortë, kurse e dyta dhe e treta janë të buta.



Ligjërimi i tekstit mund të shoqërohet me lëvizje të dorës.


3 _____ | _____ | _____ | _____ | _____ | _____ | _____ | _____ |
 4 E - ja - ni flu - tur - a n'lu - le të bu - ku - ra e - ja - ni mbli - dhu - ni fu - sha - ve hi - dhu - ni

Ashtu siç thamë më lart, rrokja e parë duhet të jetë gjithmonë më e fortë se dy rrokjet e tjera. Shqiptimi mund të bëhet edhe përmes duartrokitjeve apo goditjeve me shuplaka në bankë apo edhe me këmbë në dysheme.

Tekstit dhe ligjërimin mund t'i shtohen instrumentet e tjera me goditje.



Masa 4/4



4 _____ | _____ | _____ | _____ |
 4 o - ra bin - te tik - tak - tik - tak dit' e nat'
 ↓ ← → ↑ ↓ ← → ↑ ↓ ← → ↑ ↓ ← → ↑

Pyetje dhe detyra



Sa nota gjysmë mund të shkruajmë në masën 2/4?
 Sa nota tetëshe mund të shkruajmë në masën 4/4?

Plotësoni

1

2

Detyrë



1

Bëni ndarjen e masave.



2

Plotëso masat. Çdo masë duhet të përmbajë vlera tetëshe, katërshe dhe gjysmë:





Valsi

Johan Strauss



Valsi është lojë me prejardhje gjermane në masën 3/4 dhe në temp të shpejtë. Shquhet me melodi të lehtë, gazmore dhe elegante. Ka një ritëm karakteristik, në të cilin theksi bie posaçërisht në njësinë e parë të masës.

Kompozitori më i shquar i valsit është Johan Shtrausi, por atë me sukses e kanë kompozuar edhe kompozitorë të tjerë, si F. Shopen, P.I. Çajkovski etj.



Të dëgjojmë:

Johan Strauss: **Blue Danube**

Vallëzimi i valsit

Tema me variacione


Në këtë formë muzikore, tema paraqet idenë themelore të saj. Zakonisht ajo është një melodi e qartë, me ritëm dhe temp të thjeshtë dhe melodi që ka përmbajtje të pasur. Nëse këtë temë e ndryshojmë në ndonjë mënyrë, apo nëse atë e pasurojmë me tinguj të tjerë, ne e fitojmë variacionin (e temës).

Së këndejmi, tema me variacione është formë muzikore, e cila përbëhet prej një teme dhe përsëritjeve të saj, gjithmonë të ndryshuara. Numri i variacioneve nuk është gjithmonë i njëjtë; ai sillet prej 2-3 deri në 33 variacione.

Tema / mendimi kryesor /



Variacionet




Të dëgjojmë: 

Mozart: Variacione mbi një temë franceze



Marshi



Marshi paraqet një lloj muzike që ngjason në valle, meqë në bazë të saj zhvillohen lëvizjet e caktuara. Me muzikën e marshit ecet dhe marshohet. Marshi ka një karakter solemn, me ritëm të vendosur dhe të prerë. Është në masën 2/4 dhe 4/4/.

Marshin mund ta hasim edhe si pjesë përbërëse të veprave të mëdha si në operë, balet, simfoni etj. Dallojmë edhe marshin funeral (të përmortshëm), marshin festiv, marshin ushtarak etj.

Charles Gounod

Orkestra frymore e FSK-së




Të dëgjojmë:

Charles Gounod: **Funeral March of Marionette**

Paramasa

Shpeshherë kënga mund të fillojë me rrokje të patheksuar dhe atë e quajmë **paramasë**.

Zakonisht paramasa plotësohet me masën e fundit:



Kën - do për her' e mos pu - sho se kën - ga gjith' të gë - zon.

Ushtrim melodik





Kori gazmor dhe shkalla G-dur

B. Shehu
R. Pasmaçiu

Allegro

G D C D7 G D

Lart e posht' në o - borr po kën - don një kor ga - zmor. Pa - ta bën ga - ga - ga

C D G C G

pu - la e ku - qe kua - kua - kua. Ky është ko - ri yn' ga - zmor,

D 1. G 2.

që jep shfa - qje te ne në o - borr. te ne në o - borr


1

Lart e posht' në oborr
po këndon një kor gazmor.
Gjeli bën ki-ki-ki,
zogu i vogël ciu-ciu-ci.

Ref:
Ky është kori...





G A H C D E FIS G




Krijò muzikë në bazë të tekstit



Pi - kë pi - kë pi - kë - lon shi - u pas dri - ta - res son'
 Pi - kë pi - kë këng' e tij thot' fu - sha nëm të pi'



Lu - let shi - un shum' e dash - kan e - dhe pe - mët et - je pas - kan
 fu - shës u - jë i jep shu - më kur - se ne na vë në gju - më.





Oda e gëzimit

Moderato

L.van Bethoven (1770-1827)

Violina *f*

Piano *mf*

MBAJMË MEND!

Himni i Evropës (i cili ndryshe njihet edhe si Himni i gëzimit) është Himni i Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian. Himni evropian është pjesë nga "Odë e gëzimit" nga simfonia e 9-të e Beethoven-it.



Bashkimi Evropian

Ludwig Van Beethoven, është një nga figurat më të rëndësishme të historisë së muzikës. Që në moshë të re ai humbi dëgjimin, por përkundër kësaj, ai vazhdoi punën e tij si kompozitor dhe dirigjent deri në fund të jetës së tij.

Pyetje:

Çka do të thotë për ty liria?



Libri i historisë

Gëzueshëm

Donika Rudi
H. Morina

C **G7**

Jam në klas' të gja - shtë nuk kam ardh' me ha - tër, vet' un' kam më su - ar

G **F** **C** **F** **C**

dhe jam e da - llu - ar, li - bri i his - to - ri - së i at - dhe - ut ti - m

d-m **G7** **C**

Më pël - qen më shu - më dhe më - jep gë - zi - m

Prizreni



Nënë Tereza



A e dini se ?

Familja e Gonxhe Bojaxhiut – Nënë Terezës, ka pasur prejardhje nga Prizreni.




Vendi ynë dallohet për një traditë të gjatë kombëtare. Historia e tij e lavdishme lidhet me shumë qytete të tij, ndër të cilat shquhet qyteti i Prizrenit. Në këtë qytet, në fund të shekullit të 19-të, është zhvilluar ngjarja më e rëndësishme e traditës kombëtare – Lidhja Shqiptare e Prizrenit. Pas Luftës së Dytë Botërore, si kryeqytet i Kosovës për disa vjet me radhë, Prizreni dallohet për aktivitete të rëndësishme kulturore. Në të fillon punën shkolla e parë e muzikës në Kosovë.

Muziktarët tanë të parë, si **Lorenc Antoni** dhe **Rexho Mulliqi**, fillojnë veprimtarinë e tyre të vlefshme në fushën e muzikës klasike. Prizreni shquhet me vlera arkitektonike unike. Me të drejtë, në vitin 2018, Prizreni është shpallur kryeqytet historik i Kosovës.



Ndërtesa e Lidhjes së Prizrenit

Rexho Mulliqi, kompozitor



Lorenc Antoni, kompozitor



Lorenc Antoni: **Hypi Cuca**
Rexho Mulliqi: **Vjeshta**

Të dëgjojmë:





Vjeshta


R. Nushi
E. Zuberi



Prima dhe sekunda volta

Masa mbi të cilën është shënuar **prima volta** këndohet **vetëm** herën e parë; në përsëritje kjo masë kalohet.

Shenja **sekunda volta**, tregon taktin të cilin duhet kënduar në përsëritje.







2 Instrumentet muzikore





Instrumentet muzikore

Çdo objekt i cili krijon tingull (përmes fryrjes, goditjes etj.), konsiderohet instrument. Dikur, në kohërat e vjetra, instrumentet muzikore kanë qenë pjesë e ritualeve, sinjaleve dhe ceremonive religjioze. Instrumentet muzikore ndahen në disa kategori: instrumente me goditje, me frymë, me tela dhe me tastierë.

Instrumentet me goditje

timpani



def




tarabuka



Instrumentet me tela

violina



kitara



Harpa



Instrumentet me frymë

klarinetë



trumpetë



flautë



Instrumentet me tastierë

piano



klavseni



organo



Instrumentet elektronike

kitara elektrike



dauille elektrike



piano elektrike





Harpa



Harpa është instrument me tela. Telat e saj janë të vendosur në trupin e saj në formë trekëndëshi. Tingulli i harpës është i ëmbël dhe i qetë. Ka shtrirje të gjerë, nga tingujt e ulët e deri tek ata të lartët. Harpën e hasim më shpesh në kuadër të orkestrës, por ajo përdoret edhe si instrument solistik.

Mbajtja e harpës



Të dëgjojmë:

Claude Debussy: **Danse sacrée et danse profane**

Pianoja

Piano është një nga instrumentet më të popullarizuara. Tingulli në piano fitohet me shtypjen e tasteve ku çekani i drurit godet telin për të vibruar. Pothuajse të gjithë kompozitorët e njohur kanë shkruar vepra për piano. Ndër ta veçojmë: Franc List-in dhe Frederik Chopin-in. Nga shekulli XIX, si formë më e thjeshtë e pianos zhvillohet pianinoja. Personi që luan në piano quhet pianist.



Ivo Pogorelich – një nga pianistët më të çmuar të skenës ndërkombëtare

Të dëgjojmë: 

Pyotr Ilyich Tchaikovsky: **Kënga e vjeshtës nga "The Seasons"**



Briri (korna)



Është instrument frymor dhe i takon familjes së instrumenteve të tunxhit. Përdoret kryesisht në orkestër dhe ka rolin e mbajtjes së sfondit harmonik. Por, atë e gjejmë edhe si instrument solistik dhe në kuadër të formacioneve kamertale (p.sh.: në kuadër të kuintetit frymor). Ka një tingull të butë, sidomos në regjistrin e ulët, kurse në regjistrin e lartë dhe në dinamikën forte, mund të jetë dramatik dhe festiv.



Të dëgjojmë:

Wolfgang Amadeus Mozart: **Horn Concerto Nr. 3 KV. 447**

Timpani

Timpani i takon familjes së instrumenteve me godtije. Trupi i tij është i ndërtuar nga metali, përderisa pjesa e sipërme përbëhet nga lëkura.

Lartësia e tingullit në timpan ndryshohet përmes shtrëngimit të lëkurës, me ndihmën e pedales. Roli i timpanit në orkestër është shumë i rëndësishëm. Atë mund ta gjejmë në shumë vepra klasike: F. Poulenc, L.V. Beethoven, P. Glass etj. Personi që luan në timpan quhen timpanist.



Të dëgjojmë: 

Philip Glass: **Double Concerto for Timpani & Orchestra**



Muzika dhe artet e tjera

Marc Ricci nga e cila Antonio Vivaldi gjeti inspirimin për veprën e tij "Katër Stinët".



Antonio Vivaldi ishte kompozitor, violinist, pedagog dhe dirigjent nga Italia. Vepra e tij "Katër stinët" është e përbërë nga katër koncerte për violinë dhe orkestër, me emërtime: Pranvera, Vera, Vjeshta dhe Dimri. Secila nga to ka elemente dalluese tingullore dhe ato përshkruajnë stinët e vitit.

Antonio Vivaldi



Të dëgjojmë:

Antonio Vivaldi: **Stinët e vitit (Dimri) / Four Seasons**

Poezi e katër stinëve të vitit

Mbyllini sytë dhe mendoni për një çast lidhur me pranverën, verën, vjeshtën dhe dimrin. Çka keni në mendje? Çfarë shije e tinguj ju vijnë në mendje? Shkruani poezitë tuaja për secilën stinë.

Pranvera

Vera

Vjeshta

Dimri

Sinkopa

Në masën e katërt të të katrave, lëvizja e parë dhe lëvizja e tretë janë të theksuara, ndërsa, lëvizja e dytë dhe lëvizja e katërt e kohës janë të patheksuara.


Nëse lëvizjen e dytë të kohës e lidhim me lëvizjen e tretë, theksi në këtë masë do të ndryshojë.



Këtë dukuri ritmike e quajmë **sinkopë**.
Pra, sinkopa është kalimi i theksit të fortë në atë të butë.


Shpejt

S. Spahiu




We wish you a Merry Christmas

F **B** **g-m**



1. we wish you a mer-ry Christ-mas, we wish you a me-ry
 bring us some fi-gy pud-ding, now bring us some fig-gy
 won't go un-til we get some, we won't go un-til we
 wish you a mer-ry Christ-mas, we wish you a mer-ry

C **B** **g-m** **C7** **F**



Christ-mas, we wish you a me-ry Christ-mas, and a Hap-py New Year! God
 pud-ding, now bring us some fig-gy pud-ding, and -a cup of good cheer.
 get some, we won't go un-til we get some, so— bring some out here!
 Christ-mas, we wish you a mer-ry Christ-mas, and -a Hap-py New Year!





Erdhi Viti i Ri

K. Kono

Allegro

Ja na er- dhi

Vit'i Ri sa jam i gë - zu - ar por-si u - në çdo fë - mi

pret për ta fes - tu - ar **f** Bo-ra zbar-dhi tej për tej fu-sha e - dhe


ma - le__ Vir' i Ri do të na gjej' me këng e-dhe va - lle

**E stolisa bredhin tim
me lodra, me yje
era jashtë me tërbim
le të fryjë në pyje**

**Ref:
Plot dhurata përsëri
do të sjellë për mua
Vit' i Ri, o Vit' i Ri
sa fort unë të dua.**




Shkalla e-mol



Grada I II III IV V VI VII VIII

Shkalla e-mol është paralelja e shkallës G-dur. Fillon me tingullin: e dhe ka parashenjën: fis.



Grada I II III IV V VI VII VIII

1 ton 1 ton 1 ton 1 ton 1 ton

5 ton 5 ton

Kadenca





E FIS G A H C D E

Shqiponja dhe balona

F. Ibrahim

Qetë **H7** **e-m** **H7** **e-m**

p Dy-shqi - po - nja a - tje lart çaj-në qie-llin e pa-ndar' një-ra

G **D** **G** **H7** **e-m**

që nga ma-let er - dhi *f* ec e ec e s'di të nda - let tje-tra

G **D** **G** **H7** **e-m**

që nga do - ra ja - në vi - za - tu - ar në ba - lo - në







3 Muzika 3 vokale


Muzika vokale


Nga mënyra e performimit, muzikën e ndajmë në: muzikë vokale, instrumentale dhe vokalo-instrumentale. Muzika e cila vjen përmes këndimit quhet muzikë vokale. Muzika vokale mund të jetë **solistike**, nëse e këndon një këngëtar dhe **korale**, nëse këndohet nga ana e grupit të këngëtarëve (korit). Muzika vokale mund të shoqërohet edhe me instrumente dhe, këtë lloj të muzikës, e emërtojmë si muzikë **vokalo-instrumentale**.

Muzikën vokale e këndojnë zërat që dallojnë për nga lartësia, ngjyra dhe intensiteti.

Llojet e zërave

Zërat femërorë janë: **soprano** – zëri i lartë, **mezosoprano** – zëri i mesëm dhe **alto** – zëri i ulët.



 Ermonela Jaho, soprano e shquar shqiptare



Të dëgjojmë:

Ermonela Jaho: **Aria nga opera Puccini: Madama butterfly**



Zërat mashkullorë janë:

tenori - zëri i lartë,

baritoni – zëri i mesëm dhe

basi – zëri i ulët.



Luciano Pavarotti – një ndër tenorët më të suksesshëm të të gjitha kohërave

Të dëgjojmë:



Luciano Pavarotti: **O sole mio**



Maria Callas, soliste

Ekziston praktika e këndimit solistik dhe grupor (kolektiv). Përmes numrit të performuesve, muzika vokale mund të jetë për solist, duet, trio, kuartet dhe kor.

Derisa këndimi solistik shpreh arritjet artistike të individit, këndimi kolektiv është shprehje e muzicimit kolektiv, nën udhëheqjen e dirigjentit. Këtë këndim kolektiv e quajmë këndim koral, kurse ansamblin e quajmë kor.



Jose Carreras, solist



Duet



Trio



Kuartet

Kori është një ansambël vokal, në të cilin këndohen njëkohësisht disa vija melodike të ndryshme, në mënyrë kolektive. Atë e përbëjnë zëra të ndryshëm, që dallojnë për nga lartësia.



Kori i femrave



Kori i meshkujve



Kori i fëmijëve



Kori i përzier

Kori i femrave përbëhet nga zërat: *soprano, alto ose soprano, mezosoprano, alto*.

Kori i meshkujve përbëhet nga zërat: *tenor, bas ose tenor, bariton, bas*.

Korin e përzier e përbëjnë zërat: *soprano, alt, tenor, bas*.

Kori i fëmijëve zakonisht formohet nga fëmijët (nxënësit) e shkollave fillore. Ky ansambël ndahet në dy zëra (zëri i lartë dhe zëri i mesëm), ose në tre zëra (i larti, i mesmi dhe i ulëti).

Pyetje



1. Sa zëra femërorë njihni?
2. Cilët nga zërat mashkullorë janë më të lartët?
3. Nga cilët zëra është i ndërtuar kori i përzier?

Të dëgjojmë



Kurt Bestor: **Prayer of the children**



Kyrie

Franz Schubert, D 167

p

Sopran

Ky - ri - e e - lei - son, Ky - ri - e e - lei -

p

Alt

Ky - ri - e e - lei - son, Ky - ri - e e - lei -

p


Tenor

Ky - ri - e e - lei - son, Ky - ri - e e - lei

p

Bass

Ky - ri - e e - lei - son, Ky - ri - e e - lei



Korona është shenjë që tregon se nota zgjatet sipas dëshirës së interpretimit. Ajo vendoset mbi notë.

Solo-kënga

Solo-kënga është vepër e kompozuar për zë solo me shoqërim të instrumentit (zakonisht pianos) ose të orkestrës. Kompozohet në bazë të tekstit poetik.



Është njëra prej formave më të popullarizuara të kohës së romantizimit. Kompozitori më i famshëm i solo-këngës konsiderohet kompozitori austriak Franc Shubert.

Kompozitorë e tjerë të njohur që kanë kompozuar solo-këngën: H. Volf, J.Brams etj. Kompozitorët shqiptarë që kanë shkruar solo këngë janë të shumtë. Ndërta veçohen kompozitorët: E.Rizvanolli, V.Gjini, Z,Ballata, F.Ibrahimi etj.

Franz Schubert, kompozitor austriak i shek. të 19-të (epoka e romantizmit). Një nga kompozitorët më të rëndësishëm të solo-këngës.

Franz Schubert



Të dëgjojmë:

Franz Schubert: **Winterreise**



Vendi im

Rafet Rudi
Q. Guranjaku

Moderato


Sa py - je, ma - le, fu - sha me lu - le, kro - je t'ar - gjen - d'ta
ka ven - di im. Bu - rra vi - ga - na, djemt' si pe -
tri - ta, gra, va - sha t'bu - kra ka ven - di im.

p


**Si zë bilbili
Posi val' e detit
Vjen gjuha shqipe
E vendit tim.**



Ndryshimet e dinamikës



crescendo
rite zërin gradualisht



decrescendo
ule zërin gradualisht

Forma e këngës dypjesëshe

Formën muzikore dypjesëshe apo tripjesëshe, ju e keni mësuar në klasat e mëhershme, përmes mësimit të këngëve, por edhe përmes dëgjimit muzikor të veprave të ndryshme.

Tashmë ju do të dalloni formën e veprës dhe pjesët përbërëse të saj.

Kontrastin do ta hetoni përmes dallimeve në dinamikë, në tekst duke vërejtur dhe identifikuar, më lehtë, pjesën e dytë.

Kur buzëqesh nëna

Rafet Rudi


Vivo

e-m



Kur buz' qesh në - na i - me sa shum' lu - le çe - lin n'fu - shë Kur kë - don

D **e-m** **D**



në - na i - me ngjan bu - ri - mit me gur - gu - lli - me e di - ni çka ësh të

e-m **D** **e-m**



në - na i - me ësh - të drit' e je - tës je - tës si - me.

Forma dypjesëshe përbëhet prej dy pjesëve: pjesa e parë: a dhe pjesa e dytë: b. Dëgjoni kontrastin (melodinë, tekstin) përmes dëgjimit të këngës

a

Kur buzëqesh nëna ime
sa shumë lule çelin n'fushë
kur këndon nëna ime
ngjall burime me gurgullimë

b


E dini çka është
nëna ime
është dritë e jetës
jetës sime



Format e këngës tripjesëshe

Forma tripjesëshe përbëhet nga tri pjesë. Pjesa e parë dhe pjesa e tretë janë nga materiali i njëjtë, përderisa pjesa e mesme është pjesë kontrastuese.

Forma tripjesëshe:



Era e lehtë

The image shows three staves of musical notation in 3/4 time, illustrating the 'Era e lehtë' exercise. The first staff is labeled 'a' and features a melodic line with eighth and quarter notes. The second staff is labeled 'b' and features a different melodic line, also with eighth and quarter notes. The third staff is labeled 'a' and repeats the melodic line from the first staff. The notation includes a treble clef, a key signature of one flat (B-flat), and a 3/4 time signature.



Të dëgjojmë:

Béla Bartók: "Loja"


Forma e këngës së përbërë tripjesëshe



Kënga e përbërë tripjesëshe është formë e ndërtuar prej tri pjesëve A-B-A, ku çdo pjesë e saj ka formën e këngës së thjeshtë tripjesëshe apo dypjesëshe.

Ndryshimin më të madh melodik dhe harmonik e sjell pjesa e mesme B, e cila ndonjëherë mban emërtim të veçantë - trio.

Format e ndryshme me emërtim dhe karakter të veçantë si menueti, skercoja, marshi etj., kanë pikërisht formën e këngës tripjesëshe.




Shembull i ndërtesës tripjesëshe



Luajmë me instrumente

Ushtrime melodike



Pranvera dhe masa 6/8



Allegro

V. A. Mozart


Ti, e - ja moj pran - ver,' me gë - zim e lu - le plot, dhe

shum' bu - ri - me zgjon ma - le fu - sha gje - lbë - ron. Dhe

die - lli në mën - gjes më lind, të gjith' - ve do t'na zgjoj, që

pu - nën ta fi - lloj - më, dhe je - tën ta gë - zojm.

Masa 6/8, konsiderohet masë e përbërë dhe e rregullt ($6/8 = 3/8 + 3/8$). Në literaturë e gjejmë zakonisht në temp të shpejtë, me ç'rast masa interpretohet me dy lëvizje.





4 Tradita



Instrumentet popullore ritmike

TUPANI



Tupani është një ndër instrumentet më të vjetra. Ky instrument ka rëndësi të madhe në muzikën popullore shqiptare.

DEFI

Defi përbëhet nga druri dhe lëkura. Tingulli prodhohet duke e goditur atë me gishta.



LODRA E VOGËL




Për të prodhuar tinguj, në lodër performuesi e godet lëkurën me dy shufra të drunjta.

Instrumentet popullore melodike



ÇIFTELIA

Çiftelia është një instrument i shqiptarëve. Çiftelia ka dy tela.



SHARKIA

Sharkia është e ngjashme me çiftelinë, por më e madhe. Për dallim nga çiftelia, ajo i ka gjashtë tela.



LAHUTA

Trupi i lahutës është i ndërtuar nga druri. Harku i saj përbëhet prej qimeve të kalit. Lahuta është e përhapur në Malësinë e Gjakovës, në Dukagjin etj.



